



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr 32 prot.

Kamëz, më 27.3.2026

V E N D I M
Nr. 23 .Datë 27/3 2026
M B I

“DHËNIE NDIHME EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË NGA BUXHETI I BASHKISË”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 27.3.2026, pasi mori në shqyrtim Projektvendimin Nr.21 Datë 19.03.2026 në mbështetje të nenit 24, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 57, datë 18/07/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.597 datë 04/09/2019 kreu 4 pika 3, për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 617 datë 22.09.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime” në VKM nr. 597 datë 04.09.2019, Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz nr. 90 dt. 17.12.2025 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Detajimin e Buxhetit të Bashkisë Kamëz për vitin 2026”; **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e përdorimit të të ardhurave të bashkisë për ndihmë ekonomike me një fond prej **150.000 (njëqind e pesëdhjetëmijë)** lekë për muajin **Mars** 2026. Fondi do të përballohet sipas strukturës buxhetore Gr 0, prog., 10430, Kap.5, Art 606.
2. Miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike për familjet si më poshtë:
 - a) **[REDACTED]** me vlerën 150,000 lekë si një rast i veçantë për gjendjen shëndetësore të djalit të tij.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

